

Denis Detling

Arti dhe regjimi





Pyetja kyçe

Arti nuk kishte asgjë të përbashkët me politikën. Deri në cilën masë pajtoheni me këtë konstatim?

Tema

Kriza politike që pas vrasjes që ndodhi në Kuvend e detyroi mbretin të vendosë diktaturë (personale). Jugosllavizmi i integruar, përndjekjet politike, censura, kufizimi i lirive qytetare, janë disa nga karakteristikat e diktaturës së Mbretit Aleksandër. Nëse kësaj ia shtojmë gjendjen e keqe ekonomike, si manifestim i Depresionit të Madh, mund të flasim për situatën në vitet e para të dekadës së katërt të shek. XX në Jugosllavi. Pyetja kyçe është si ndikoi kjo në art dhe cilat ishin raportet mes artit dhe regjimit.

Edhe pse kjo çështje nuk ishte e ndjeshme dhe kontroverse, ajo është interesante për shkak të konstatimit që mundëson qasje në temat politike nga një këndvështrim tjetër, nëpërmjet prizmit të Grupit të Tokës, Ekspozitat Pranverore në Beograd dhe dy artistët e njohur botërisht – Antun Augustinçiq dhe Ivan Meshtroviq. Edhe pse për artin (dhe jo vetëm në atë kohë) ishte i interesuar një rreth i ngushtë i njerëzve, i cili ishte i përqendruar në qendrat e mëdha, veçanërisht në Zagreb dhe Beograd, arti është i rëndësishëm jo vetëm sepse paraqet shprehje të situatës në vend dhe në shoqëri por edhe pse kjo është shprehje e të menduarit dhe veprimeve të elitës politike dhe kulturore.

Qëllimi i punëtorisë është të tregojë, me ndihmën e disa burimeve, raportin mes artit (vizual) dhe regjimit të Mbretit Aleksandër në vitet e 1930-ta dhe idenë unitetit nacional, por gjithashtu edhe raportet e regjimit përballë artit (vizual). Qëllimi i punëtorisë është që ta arrijë qëllimin e të menduarit kritik me ndihmën e burimeve historike.

Rezultatet e mësimt:

- Nxënësit do të mësojnë diçka për grupin e artistëve Toka, Antun Augustinçiqin, Ivan Meshtroviqin, Ekspozitat pranverore në Beograd në vitet e 30-ta të shek. XX në Mbretërinë Jugosllave.
- Nxënësit do të mund ta kuptojnë pozitën e artistëve ndaj regjimit dhe anasjelltas.
- Nxënësit do të mund të marrin qëndrim, ta shprehin mendimin e tyre duke i shfrytëzuar argumentet.

Qëllimet

- Të bëhet analizë kritike e burimeve historike.
- Të jepen tre perspektiva të ndryshme për temën arti dhe regjimi nëpërmjet materialeve të zgjedhura.
- Ta tregojnë raportin mes artit (vizual) dhe regjimin e Mbretit Aleksandër në vitet e 30-ta të shek XX, idenë e unitarizmit kombëtar, por edhe qëndrimin e regjimit ndaj artit.
- Të tregojë pozitën e artistit ndaj regjimit.
- Ta shfrytëzojë artin si burim historik.
- Të arrijë mendim kritik me ndihmën e burimeve historike dhe të inkurajojë diskutimin.

Udhëzime për mësimdhënësin

Nxënësit do të fitojnë dije, kuptim dhe qasje në temë nëpërmjet materialit të zgjedhur – burimet (fotografitë, burimet e shkruara, hartat) dhe tekstet e përgatitura hyrësve. Materialet e zgjedhura japin tre perspektiva të ndryshme për temën e Arti dhe regjimi nëpërmjet materialeve të zgjedhura. Puna në burimet dhe multiperspektivën duhet të ndihmojnë që tema të kuptohet dhe të përgjigjet në pyetjen kyçe.

HAPI 1

Hyrje – sqarimi i punëtorisë dhe dhënia e pyetjes kyçe: “Arti nuk kishte asgjë të përbashkët me politikën”. Deri në cilën masë pajtoheni me këtë konstatim?

HAPI 2

Nxënësit punojnë në tre grupe me burimet e zgjedhura dhe nëpërmjet ndihmës plotësuese nga hartat. Ekzistojnë katër lloje të burimeve – burime të shkruara, fotografi, harta dhe riprodhim të veprave artistike. Të gjitha tre grupet kanë detyrë të njëjtë, por pohime të ndryshme – grupet duhet të gjejnë cilat nga pohimet e theksuara janë të sakta dhe ta sqarojnë pyetjen e vetë.



45
minuta

Grupi 1

Burimet: Biseda mes Mbretit dhe Ivan Meshtroviqit; Olga Manojloviq për glorifikimin e pushtetit; Harta e përmendoreve publike të Mbretit Aleksandër (dhe Petar) të cilat i bëri Antun Augustinçiq; Përmendorja e Mbretit Aleksandër në Varazhdin dhe e Titos në Kumrovec të cilat janë të bëra nga Antun Augustinçiq; Skulptura 'Pijanecët'.

Pohime:

Meshtroviq dhe Augustinçiq ishin kritikues ndaj regjimit.
Puna artistike e Augustinçiqit dhe Meshtroviqit ishte në shërbim të regjimit.
Meshtroviq dhe Augustinçiq ishin politikisht të angazhuar.
Puna artistike e Augustinçiqit dhe Meshtroviqit ishte glorifikues për mbretin.
Augustinçiq dhe Meshtroviq ishin, në rend të parë, artistë të shkëlqyeshëm.

Grupi 2

Burimet: Mungesa e disa prej artistëve më të mirë me ekspozita pranverore; Blerja e veprave artistike sipas numrit të ekzemplarëve dhe çmimit; Emrat e veprave artistike nga ana e Pallatit (me hartë shtesë); Propozimi i Pallatit për blerjen e pikturave dhe skulpturave; Rëndësia e blerjes së veprave artistike.

Pohime:

Artistët në Ekspozitat Pranverore e promovonin unitetin jugosllav në art.
Ekspozitat Pranveror ishin vendtakim i artistëve të jashtëzakonshëm nga hapësira e tërë Jugosllavisë.
Pallati (mbreti) dhe ministria përgjithësisht i ndihmonin ekspozitat që të promovojnë unitetin jugosllav.
Pallati (mbreti) me rastin e blerjes së veprave mbante llogari vetëm për cilësinë e veprave.

Grupi 3

Burimet: Programi i grupit 'Toka'; Tabakoviq; Kulti i idiotizmit (1929); Vanja Radaush: Rëfimi (1932); Krsto Hegedushiq: Rekuizicioni (1929); Antun Mezgjijq: deponia (1932); Oton Postruzhnik: Përshëndetje (1932); Zheljko Hegedushiq: 6.1. (1935).

Pohime:

Puna artistike e Grupit 'Toka' shpreh kritikë ndaj rrethanave shoqërore, politike dhe ekonomike.
Puna artistike e Grupit 'Toka' e shprehte gatishmërinë e tyre që ta kritikojnë gjendjen aktuale, ndaj puna e Grupit u ndalua për këtë arsye.

HAPI 3

Përfaqësuesit e secilit grup duhet të shënojnë në linjë (mes dy pohimeve ekstreme: Arti nuk kishte asgjë të përbashkët me politikën / Arti ishte në lidhje të ngushtë me politikën) përgjigjet e tyre në përputhje me argumentimin e punës së tyre grupore.

Arti nuk kishte asgjë të përbashkët me politikën

↑

neutral

↓

Arti ishte në lidhje të ngushtë me politikën.

HAPI 4

Debat final për pyetjen kyçe.

Grupi 1

Pohime

Cilat nga pohimet vijuese janë të sakta? Sqaro me ndihmën e burimeve!

- Meshtroviq dhe Augustinçiq ishin kritikues ndaj regjimit.
- Puna artistike e Augustinçiqit dhe Meshtroviqit ishte shërbim të regjimit.
- Meshtriviq dhe Augustinçiq ishin politikisht të angazhuar.

Konteksti

Antun Augustinçiq dhe Ivan Meshtroviq ishin mes skulptorëve më të rëndësishëm në Mbretërinë Jugosllave në periudhën mes luftërave, e njëkohësisht edhe artistë me famë botërore. Me shembullin e dy skulptorëve mund pjesërisht të tregohet raporti i artit ndaj regjimit të mbretit Aleksandër.

Ivan Meshtriviq ishte skulptori më i njohur dhe më i popullarizuar kroat dhe njëri nga artistët më bashkëkohorë botërore të shek. XX. Derisa deri në fund të Luftës së Parë Botërore u angazhua politikisht duke punuar në idenë e jugosllavizmit, në Mbretërinë e Jugosllavisë me shkathtësi i anashkalonte konfliktet e drejtpërdrejta politike në Mbretërinë Jugosllave.

Në vitet e para pas 1930 ai i ekspozoi punimet e tija në Zagreb dhe Beograd (në mes tjerash edhe në ekspozitën e dytë dhe të katërt pranverore), Evropë (Londër, Paris, Berlin, Pragë, Mançester, Leeds, Belfast, Munihi, Valencë, Barcelonë, Vjenë, Cyrih, Buksel...) dhe Amerikë (Çikago, Nju Jork).

Antun Augustinçiq krahas Ivan Meshtroviqit është skulptori më i rëndësishëm kroat i shek. XX, e gjithashtu botërisht i njohur sipas përmendoreve të realizuara anekënd botës. Augustinçiq ishte një nga themeluesit e grupit artistik 'Toka' nga i cili doli në vitin 1933. Nga vitet e tridhjeta i intensifikoi aktivitetet e tija me përmendoret publike. Duke vepruar dhe shpesh duke fituar në konkurse të shumta publike për përmendoret në Jugosllavi dhe botë, e fitoi renomenë e mjeshtrit të përmendoreve, veçanërisht të përmendoreve me kuaj, që në mesin e kolegëve ia jep statusin e skulptorit të parë shtetëror.

Burimi 1

Biseda mes mbretit dhe Ivan Meshtroviqit

Biseda është zhvilluar gjatë pozimit për bërjen e bustit pasi që revista e Zagrebit (me orientim projugosllav) Nova Europa, të cilën e botoi dr. Millan Çurçin, e botoi në numrin e 26 janarit 1929 deklaratën me titull Gjendja e Re, të cilën e nënshkruan: dr. Laza Popoviq, dr. Ivan Politeo, dr. Ivan Belin, dr. Milan Çurçin dhe Meshtroviq. Në deklaratë është shprehur kritikë për vendosjen e diktaturës, si mënyrë jodemokratike e zgjidhjes së problemeve. Ky numër i Nova Evropa për shkak të deklaratës u ndalua.

-Po çka bën ky Çurçini i Juaj? A nuk e sheh ai që kjo nuk është Anglia dhe që këtu nuk mundet si tek ata?... Do ta burgos atë. Ai do të del para gjyqit.

-Nëse është ashtu, atëherë duhet të dalim para gjyqit të gjithë që me të e nënshkruam deklaratën.

-Nuk është e thënë të jetë ashtu. Nëse dikë prej jush nuk do ta burgos, dhe nuk do të ju burgos për shembull Juve, ndërsa të tjerët do t'i burgos, a mund të bëjë dikush diçka për këtë?

-Po, ai e përpiloi, por edhe ne të tjerët e nënshkruam. Ai na e lexoi deklaratën, ndërsa ne, me vërejtje të vogla, u pajtuam me atë dhe e nënshkruam. Andaj, më duket se është e drejtë – nëse është e drejtë – të gjithë përgjigjemi baras, nëse ka përgjegjësi.

Mbreti heshti për një kohë, dhe më pas qeshi dhe tha:

-Do të shohim se çka do të bëjmë me të. Kësaj here zgjodhi shoqëri të mirë, por, nëse nuk përmirësohet, asgjë nuk do t'i ndihmojë.

-Dr. Çurçin ia donë të mirën vendit tonë, si secili në vendin tonë.

-Jam i prirë ta kuptoj këtë, por ka edhe të tjerë që ia duan të mirën këtij vendi, dhe duhet të heshtin, sepse mënyra se si ata duan t'i ndihmojnë, nuk shkon, ndërsa çka nuk shkon nuk është e dobishme.

Më pas iu futëm punës. Ai qëndronte i heshtur dhe në atë pozim të parë nuk biseduam shumë.

Ivan Mestrovic, Uspomene na političke ljude i događaje, Nakladni zavod Matice hrvatske, Zagreb, 1993., 185

Burimi 2

Olga Manojloviq për glorifikimin e sundimtarit

"Kështu në periudhën para shpërthimit të Luftës së Dytë Botërore – në kohën e konflikteve më të nxehta politike dhe parashtrimit të kërkesës për decentralizim të shtetit, glorifikimi i personalitetit të mbretërve Petar dhe Aleksandër e afirmoi idenë e centralizmit shtetëror dhe unitetit nacional, në mënyrë thujtase identike siç është madhërimi i kultit të sundimtarit në kohën e Jugosllavisë socialiste, e posaçërisht në dekadën e fundit të ekzistimit të saj".

Olga Manojlović Pintar, "Tito je stena" (dis)kontinuitet vladarskih predstavlanja u Jugoslaviji i Srbiji 20. veka, Godišnjak za društvenu istoriju, 2-3-, 2004., 86-87

Burimi 3

Harta e përmendoreve publike të mbretit Aleksandër (dhe Pjetrit) të cilat i bëri Antun Augustinçiq



Antun Augustinçiq – monumentet e Mbretit Aleksandër (dhe Petar)
Ngjyra e kaltër – monumente të realizuara (dhe të demoluara në Luftën II Botërore)
Ngjyra e kuqe – skema për monumente
Të dhënat janë marrë nga Galeria e A. Augustinçiqit në Klanjac,

harta e përpiluar nga Denis Detling.

Burimi 4

Përmendorja e mbretit Aleksandër në Varazhdin dhe e Titos në Kumrovec të cilat i ka bërë Antun Augustinçiq

Monumenti i Aleksandërit I Bashkuesit i ngritur në Varazhdin në vitin 1935 (i rënduar në vitin 1941). Përmendorja e Josip Broz Titos e vendosur në Kumrovec në vitin 1948.



*Gradski muzej Varazhdin 61552 /
en.wikipedia.org/wiki/File:Tito_spomenik1.jpg*

Izvor 5

Skulptura “Të dehurit”

Skulptura “Të dehurit” nga autori Antun Augustinçiq, shpreh në figurë të plotë dy figura mashkullore – xhandarin e dobët dhe financierin e trashë (personifikimi i regjimit) – se si të përçafuar tunden dhe këndojnë. Si asnjë tjetër nga skulpturat e tija të njohura, “Të dehurit” qartë dhe me zë e shprehin shpirtin e Grupit Toka (themelues dhe pjesë e së cilit ishte edhe Augustinçiq deri në vitin 1933), më fuqishëm dhe më fortë sesa që e bënë vizatimet e tija të angazhuara në të cilat ndërvepronte në ekspozitat vendore. Ajo që “Të Dehurit” në atë kohë nuk u ekspozua dhe qartësia e shprehjes artistike na përkrahën në konstatimin që u krijuan si reaksion i Augustinçiqit në ndalesën policore të të gjitha aktiviteteve Grupit Toka në prill 1935, që përputhet me konstatimin e pronarit të tanishëm që edhe pronarja origjinale Ksenija Kantoci skulpturën e daton të jetë e vitit 1935.

Ekspertiza përgjegjësit të galerisë së A. Augustinçiqit në Klanjac, Mr. Bozhidar Perković; fotografia e skulpturës: Davorin Vujićiq

Grupi 2

Pohime

Cilat nga pohimet vijuese janë në rregull? Sqaroi me ndihmën e burimeve!

- Artistët në ekspozitat e pranverës e promovonin unitetin jugosllav në art.
- Ekspozitat e pranverës ishin vendtakim të artistëve të theksuar nga hapësira e tërë Jugosllavisë.
- Pallati (mbreti) dhe ministria i ndihmonin ekspozitat me qëllim të promovimit të unitetit jugosllav.
- Pallati (mbreti) me rastin e blerjes së veprave mbante llogari vetëm për cilësinë e veprave.

Konteksti

Organizuar nga shoqata artistike "Cvijeta Zuzoriq", të ashtuquajturat "Ekspozitat pranverore" u mbajtën në Beograd që nga viti 1929. Ata ishin vazhdim i të ashtuquajturave "Ekspozita jugosllave" që u organizuan nga viti 1904.

Burimi 1

Mungesa e disa prej artistëve më të mirë në Ekspozitën Pranverore

"Jo vetëm që mungojnë shumica e artistëve më të mirë që janë jashtë vendit – Milunović, Dobrović, Shumanović, Uzelac – mungesa e të cilëve arsyetohet, por mungojnë edhe një numër i madh i artistëve të cilët janë në vend. Artistët e Beogradit janë të përfaqësuar thuajse të gjithë, sillovenët mezi tre-katër, ndërsa prej artistëve kroatë mungojnë më të mirët, saktësisht ata veprat më të mira të së cilëve pritëshin me padurim: nuk është Meshtrović, Krshnić, Babić, Misha, Augustinčić, Bečić. Ata i përfaqësojnë, në masë të madhe, artistët e dobët, prej të cilëve vetëm disa duhej të marrin pjesë në ekspozitë dhe me numër të reduktuar të punimeve".

M. Kašanin, *Umetničke kritike, Beograd 1968, str. 143-144.* u R. Vučetić: *Cvijeta Zuzorić i kulturni život Beograda 1918–1941., Beograd, 2003.*

Burimi 2

Blerja e veprave artistike sipas numrit të veprave dhe çmimeve

Blerëso/ekspozita	Ministria e Arsimit	Autoriteti komunal	Oborri Mbretëror	Personat privatë
Ekspozita e dytë e vitit 1930	23	26	0	12
Ekspozita e tretë e vitit 1931	28 (101 000 din)	4	28 (72 900 din)	8
Ekspozita e pestë	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	1

Të dhënat janë marrë nga: R. Vučetić, *Cvijeta Zuzorić i kulturni život Beograda 1918–1941., Beograd, 2003., str.712.* (AJ, 66-376-614; AJ, 74-350-182; AJ, 74-494-199)

Pyetje opsioni:

- Kush ishte blerësi më i madh i veprave?
- Çka mendon për këtë?
- Përpiqu ta sqarosh përse zvogëlohet numri i punimeve të blera nga ana e personave privatë?
- Çka mendon, a ka kjo lidhje me cilësinë e punimeve të ekspozuara?

Burimi 3

Rëndësia e blerjes së veprave të artit

Shoqata "Cvijeta Zuzoriq", organizatore e Ekspozitave Pranverore, në korrespondencën e saj me Ministrinë e Arsimit e arsyeton rëndësinë e blerjes së veprave.

"...deri tani në ekspozitat pranverore blerësi më i madh ishte Lartmadhëria e Tij Mbreti dhe Ministria e Arsimit, pikërisht për shkak se në këto ekspozita reprezentative merrnin pjesë artistët nga i tërë shteti".

Radina Vučetić, *Jugoslavenstvo u umjetnosti I kulturi – od zavodljivog mita do okrutne realnosti (Jugoslavenske izložbe od 1904.-1940.), Časopis za suvremenu povijest, br 3., Zagreb, 2009., 712.; prema Arhiv Jugoslavije, 66-113-366*

Pyetje opsioni:

- Sipas mendimit tënd cila është arsyeja që Mbreti dhe Ministria e Arsimit ishin blerësit më të mëdhenj të pikturave?

Burimi 4

Letër Ministrisë së Arsimit

Pas mbarimit të Ekspozitës së Dytë Pranverore, piktorët Jovan Bijeliq dhe Vaso Pomorishac, në maj të vitit 1930, i shkruan ministrin se ekspozita e përbashkët arriti sukses "si me nivelin e lartë të veprave të ekspozuara, ashtu edhe me një moment tjetër – gjejësisht, kur të gjitha forcat popullore u bashkuan për të mirën e atdheut, në këtë kohë u gjetën të bashkuar pionierët e idesë jugosllave".

Radina Vučetić, Jugoslavenstvo u umjetnosti I kulturi – od zavodljivog mita do okrutne realnosti (Jugoslavenske izložbe od 1904.-1940.), Časopis za suvremenu povijest, br 3., Zagreb, 2009., 71o.; prema Arhiv Jugoslavije, 66-381-617

Pyetje opsioni:

- Çka e konsideronin si sukses më të madh piktorët në Ekspozitën e Dytë: nivelin e lartë të veprave të ekspozuara apo atë që në ekspozitë u mbledhën ata të cilët mbështesnin unitetin jugosllav?

Burimi 5

Titujt e disa veprave artistike të cilat i bleu Pallati Mbretëror (me hartë shtesë)

Gjatë blerjes së pikturave nga ana e Oborrit është vërejtur se më së shpeshti bliheshin vepra me motive të natyrës së qetë dhe vepra të cilat lidhën vende të ndryshme të Jugosllavisë, që mund të shihet nga titulli i veprës:

Motiv nga Ohri
Motiv deti
Shtëpi dalmatine
Velesi
Rreth Tetovës
Ishulli i Korçullës
Nga Hvari
Pamje nga tregu i Prizrenit
Magllaj në Bosnje

R. Vučetić, Cvijeta Zuzorić' i kulturni život Beograda 1918–1941., Beograd, 2003., str.712,713 (Arhiv Jugoslavije, 66-376-614);

Pyetje opsioni:

- Sipas mendimit tuaj, përse i kushtohej kujdes blerjes së pikturave që kishin të bëjnë me pjesët e ndryshme të Jugosllavisë?

Burimi 6

Propozimi i Oborrit për blerjen e pikturave dhe skulpturave

Propozimi për blerjen e pikturave dhe skulpturave për Oborrin përmbante mbiemrin dhe emrin e artistit dhe duhej të përmbajë karakteristika të veprës së ekspozuar. Në realitet kjo dukej kështu:

Vidmar Nande - sloven nga Lubjana. Merr motive nga jeta popullore.

Kralj France - nga Lubjana, udhëheqës i gjeneratës e cila u shfaq pas çlirimit.

Palaviçini Petar – dalmatin me prejardhje. Jeton dhe vepron në Beograd.


Ruzhička Kamilo – Piktur nga Zagrebi, merr pjesë në të gjitha ekspozitat jugosllave.

Uzelac Milivoj – i lindur në Mostar, jeton në Paris. Llogaritet si njëri ndër përfaqësuesit kryesorë të artit tonë bashkëkohorë. Ka reputacion të mirë në botën e jashtme.

R. Vučetić, Cvijeta Zuzorić' i kulturni život Beograda 1918–1941., Beograd, 2003., str. 713; prema Arhiv Jugoslavije, 74-243-366

Pyetje opsioni:

- Sipas mendimit tuaj, pse i kushtonin vëmendje që gjatë blerjes së vizatimeve ata të jenë të lidhura me pjesë të ndryshme të Jugosllavisë?



Grupi 3

Pohime

Cilat prej pohimeve vijuese janë të sakta? Sqaro me ndihmën e burimeve!

- Puna artistike e Grupit “Toka” shpreh kritikë ndaj rrethanave shoqërore, politike dhe ekonomike.
- Punimet artistike të Grupit “Toka” e përkrahnin politikën e regjimit.
- Programi i Grupit “Toka” e shprehte gatishmërinë e tyre për kritikën e gjendjes aktuale, ndaj puna e Grupit për këtë arsye është ndaluar.

Konteksti

Grupi “Toka” (emri i plotë: Shoqata e artistëve figurativë Toka) ishte shoqatë statusore e artistëve figurativë të angazhuar, me orientim politik të majtë e cila veproi nga viti 1920 deri në vitin 1935.

Grupi i themelua në kohën e shpërthimit të krizës ekonomike, vdekjes së Stjepan Radiqit dhe vendosjes së diktaturës. Ndikim të madh të drejtpërdrejtë në Grupin “Toka” kishin letrari Miroslav Krležha, piktori gjerman Georg Grosz dhe grupi figurativ gjerman Realiteti i Ri (Neue Sachlichkeit).

Anëtarët e grupit përpiqeshin për artin i cili nuk ishte qëllim i vetes, por është i angazhuar në aspektin shoqëror dhe politik dhe në dispozicion të shtresave të gjera popullore (që do të ndikojnë në themelimin e pikturimit naiv kroat nga ana e Krste Hegedushiqit). Tema dhe motivet i ndërmoren nga mjedisi i tyre, vendi nga e kishin prejardhjen (së këndeji edhe emërtimi “Toka”), ndërsa më së shumti merreshin me problemet e fshatit kroat. Grupi kishte qëndrim kritik, polemizues dhe në veprimin e tij me shkathtësi e anashkaloi censurën dhe kujdesej që mos të provokoj publikisht reagimin e regjimit.

Anëtarë të Grupit “Toka” ishin artistë shumë të njohur kroatë, ndërsa mes tyre Drago Ibler (kryetar), Antun Augustinçiq, Krsto Hegedushiq, Frano Krshiniq, Marijan Detoni, Ivan Generaliq, Zheljko Hegedushiq. Grupi organizoi 6 ekspozita, në të cilat i prezantuan veprat e tyre të angazhuara anëtarët, por edhe mysafirët e Grupit “Toka”.

Burimi 1

Programi i Grupit “Toka”

“Duhet të jetohej me jetën e kohës tënde.

Duhet të krijohet me frymën e kohës tënde.

Jeta bashkëkohore është ndikuar nga idetë sociale dhe çështjet kolektive janë dominuese.

Artisti nuk mund të largohet nga kërkesat e shoqërisë së re dhe të qëndrojë jashtë kolektivit sepse arti është shprehje e këndvështrimit të botës, sepse arti dhe jeta janë një”.

Programi i Grupit “Toka” i shpallur publikisht për shkak të censurës ishte i formuluar në mënyrë precize. Edhe pse grupi me veprimin e vet, si dhe në formulimin e programit, me shkathtësi e anashkaloi censurën dhe kujdesej që publikisht mos të shkaktojë reagimin e regjimit, regjimi në vitin 1935 e humbi durimin dhe e ndaloi veprimin e grupit pa sqarim.

Izložba Udruženja umjetnika Zemlja, Zagreb, 1929.

Burimi 2

Ivan Tabaković: Kulti i idiotizmit (1929)



*Izložba Udruženja umjetnika
Zemlja, Zagreb, 1929.*

Pyetje opsioni:

1. Çka sheh në pikturë?
2. Kulti shënon respektimin e dikujt apo të diçkaje. Çka dëshironte të thotë autori me titullin e veprës?

Burimi 3

Vanja Radaus:
Feja (1932)



Izložba Zemlja u
Umjetničkom paviljonu,
Zagreb, 1932.

Pyetje opsioni:

- Cili është imazhi i priftit, e cili i gruas që lutet?

Burimi 4

Krsto Hegedushiq: Rekuizicioni (1929)



Izložba udruženja umjetnika Zemlja, Zagreb, 1929.: <http://www.ipress.hr/kultura/izložba-krste-hegedusica-za-deset-godina-galerije-adris-14514.html>

Pyetje opsioni:

1. Çka është shprehur në këtë vizatim?
2. Rekuizicion do të thotë marrja e detyrueshme, respektivisht e përkohshme e pronës nëpërmjet kompensimit, zakonisht për qëllime luftarake. Çka mendon ti, a do të fitojnë kompensim fshatarët nga fotografia?

Burimi 5

Antun Mezgjijq: Mbeturinat (1932)

Izložba Zemlja u Umjetničkom
paviljonu, Zagreb, 1932.



Pyetje opsioni:

1. Në prapavijën e vizatimit është Zagrebi, por çka shpreh vizatimi?
2. Çfarë lidhje ka në lidhje me titullin e ekspozitës?

Burimi 6

Oton Postruzhnik: Përshëndetja (1932)



Izložba Zemlja u
Umjetničkom paviljonu,
Zagreb, 1932.

Pyetje opsioni:

1. Flamuri është simbol i një shteti. Si do ta mbaje ti flamurin e vendit tënd kur dikush do ta përshëndeste?
2. Si është paraqitur këtu?
3. Numëro sa persona ka në vizatim dhe sa fytyra sheh?
4. Te fytyrat që i sheh, a bëhet fjalë për ndonjë person konkret apo ndoshta ajo e paraqet dikë?

Burimi 7

Zheljko Hegedushiq: 6.1 (1935)



Moderna galerija
Zagreb, MG-2891;
photo by Goran Vranic.

Pyetje opsioni:

1. Titulli i pikturës është 6.1. Çka ka ndodhur në datën 6.1.1929?
2. Të gjitha personazhet në këtë pikturë ecin drejt gurit në të cilin shkruan 6.1. Çka mendon, çka dëshiron të thotë autori me këtë pikturë?
3. Shiko cilat figura gjenden në pikturë. Si janë paraqitur?
4. A paraqesin persona realë apo ata figura paraqesin grupe të caktuara?
5. Nëse paraqesin grupe të caktuara, cili është qëndrimi i autorit të pikturës ndaj tyre?
6. Çka mendon për të? A shfaqet diku vdekja në prapavijë?
7. Çka i parapriu ngjarjes së 6.1.1929?
8. Çka mendon cili është qëndrimi i autorit, në bazë të pikturës, sipas ngjarjes e cila ndodhi më 6.1.1929?